



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 59, PARAQITUR NË KQZ  
NË DATËN 08.07.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 09.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Aleanca Demokratike Shqiptare

**OBJEKT:** Kundërshtimi i vendimit të KZAZ nr.18 Bulqizë për disa qendra votimi.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "a" dhe neni 126, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 59 regj, datë 08.07.2019.



Në mbledhjen e datës 09.07.2019, ora 10:00 pas relatimit të z. Klement Zguri, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 59 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore duhet të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 59, datë 08.07.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike Shqiptare.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 11.07.2019, në orën 17:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

